



VENDIM

Nr. 142 Datë 22.11.2013

PËR

**KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “GJOKA
KONSTRUKSION - ENERGJI” SH.P.K NGA HEC- ET “LENIE”,
“SHALES” DHE “STRELCË”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “l”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 9 pikat 1 dhe 2 gërma “a” të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007; Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 22.11.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gjoka Konstruksion Energji” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për Hec- et “Lenie”, “Shales” dhe “Strelcë”, si burim i rinovueshëm energjie,

Konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Gjoka Konstruksion Energji” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.
- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**
Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.
Ky dokumentacion është paraqitur ne mënyrë korrekte.
- **Neni 7 pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”**
Përshkrimi i centralit..
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi :

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Gjoka Konstruksion Energji” sh.p.k, nga Hec- et “Lenie”, “Shales” dhe “Strelcë”, si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s
Petrit AHMETI